

lajmi.net

Iu gjetën pistoletë e sëpatë, arrestohet personi



17/08/2023 09:25

f

✈

🔗

Një person është arrestuar në Pejë për armëmbajtje pa leje.

Në njoftimin e Policisë së Kosovës bëhet e ditur se ai është arrestuar gjatë realizimit të planit “Goditja”, dhe se të njëjtit i janë gjetur një pistoletë, një karikator, tetë fishekë dhe një sopatë.

“Më datë 16 gusht 2023 rreth orës 21:15, gjatë realizimit të planit operativ “Goditja”, patrullat Policore deri sa ishin në pikë kontrolli në rrugën “Mulla Zekë Berdyna” në Pejë, kanë ndaluar një automjet me targa vendore, dhe gjatë kontrollit tek i dyshuari është gjetur dhe sekuestruar:

- Një (1) armë (pistoletë) e tipit TT kal: 7.62mm
- Një (1) karikator i së njejtës armë
- Tetë (8) fishekë kal: 7.62mm dhe
- Një (1) Sëpatë”, thuhet në njoftim.

Bëhet e ditur se pas intervistimit nga hetuesit, me vendim të Prokurorit të shtetit rasti ka shkuar në procedurë te rregullt.

Artikuj të ngjashëm



August 17, 2023

Specialja ua vazhdimin e paraburgimit për Thaçit dhe Veselit



August 17, 2023

“Goditja”, policia kap thika, boksa metali, elektroshokë e sprej: Pas arrestimit...



August 17, 2023

Serbët do të kenë autonomi në Kosovë, por jo për t'u...



August 17, 2023

“Po e vëzhgojmë situatën nga afër”, Hovenier reagon për dorëheqjen e...



August 17, 2023

Kurti e Murati vazhdojnë vizitat nëpër kompanitë , këtë radhë vizitojnë...



August 17, 2023

Edhe një pjesëtare e FSK-së bëhet pjesë e Akademisë Mbretërore Ushtarake...